

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

**8.10.2024
Ora 12:07**

RENDI I DITËS

**Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Malësi e
Madhe, Fier, Elbasan, Kukës dhe Peqin”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
**- Stafii KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi, z. K. Puleri,
z. M. Bardhi**
Parti Politike: PDIU (z. Sh. Sulo)
Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, atëherë në seancën e sotme publike, kemi në rendin e ditës këto çështje:

- Projektvendim “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.
- Shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.
- Pastaj janë disa projektvendime që lidhen me plotësimin e vakancave në këshillat e Bashkisë Malësi e Madhe, Bashkinë Fier, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Kukës, dhe Bashkinë e Peqinit.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*


Mendoj të shqyrtojme plotësimin e vakancave dhe pastaj vazhdojmë me çështjet e tjera të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Faleminderit Kryetar! Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe, Këshilli i Bashkisë Fier, Këshilli i Bashkisë Elbasan, Këshilli i Bashkisë Kukës dhe Këshilli i Bashkisë Peqin kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave në këto këshilla. Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor kemi vijuar me verifikimin e kandidatëve të rradhës nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore përkatëse. Kemi verifikuar formularët e vetëdeklarimit të cilët janë dorëzuar nga vetë kandidatët. Më pas kemi vijuar me verifikimin e mëtejshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Nga përgjigjet e tyre ka rezultuar se të gjithë kandidatët nuk kanë dënime me vendim penal të formës së prerë, në ngarkim të tyre. Në mbështetje të pikës 2, Kreut 5, të vendimit 17/2016 të Kuvendit, konstatohet se kandidatët nuk përbëjnë kusht për moszgjedhshmërisë e tyre. Pra, të dhënat e deklaruara në formularin e dekriminalizimit dhe nga verifikimet, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhshmërinë e tyre në funksionin e anëtarit të këshillit bashkiak. Bashkëlidhur kemi dhe projektvendimet përkatëse.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Malësi e Madhe, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, zotin Ardian Demaj.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, zotin Ymer Goga.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, zonjën Kejdi Resuli.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zotin Ymer Balliu.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kukës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë “Nisma Thurje”, zotin Florin Syla.
- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Peqin, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, zonjën Donika Karina.

Vendimi nr. 180, 181, 182, 183, 184, 185.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

8.10.2024

Ora 12:10

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**- Stafit KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi, z. K. Puleri,
z. M. Bardhi.**

Parti Politike: PDIU (z. Sh. Sulo)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te çështja tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023.

Znj. J. Josifi: I nderuar Komisioner! Projektvendimi që është sot për në vlerësimin tuaj lidhet me miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023. Ky raport përmban gjetjet nga auditimi që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka bërë fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

partitë politike për këtë proces zgjedhor. Neni 19, pikat 1, shkronja “ë” dhe “n” si dhe 2, të Kodit Zgjedhor, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të monitoruar nëpërmjet administratës së KQZ-së, apo subjekteve të kontraktuara fushatën zgjedhore, të gjitha aspektet e financimit të saj, pasqyrimin e fushatës në media, si dhe për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë tjetër që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullatorit apo atij të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në nenin 21, pika 1 shkronja “dh”, të Kodit Zgjedhor është parashikuar se me kërkesë të Komisionerit, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas daljes së rezultatit përfundimtar i dërgoi njoftim zyrtar të gjitha subjekteve zgjedhore për detyrimin që ata kanë për të dorëzuar raportet financiare të fushatës në KQZ. Nga dyzet e gjashtë subjekte zgjedhore të regjistruara për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të cilave iu dërgua njoftimi, tridhjetë e gjashtë subjekte zgjedhore dorëzuan raportet financiare për fushatën zgjedhore, ndër të cilët tridhjetë e dorëzuan atë në platformën elektronike të ngritur për këtë qëllim dhe gjashtë subjekte zgjedhore e dorëzuan raportin financiar në version në letër. Ndërkohë dhjetë subjekte zgjedhore nuk e dorëzuan këtë raport fare, për fushatën e zgjedhjeve të datës 14 maj 2023. Projektvendimi që keni përpara jush ka konstatuar në bazë të auditimeve të bëra nga audituesit ligjorë të kontraktuar nga KQZ, se kemi disa sanksione të cilat janë evidentuar dhe do të propozohen masa Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

- Sanksione për subjektet zgjedhore për mosdorëzim të raporteve të kandidatëve të këtyre subjekteve, qoftë për kandidatët për kryetar bashkie, qoftë të kandidatëve të listave shumemërore.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

- Sanksion për subjektet zgjedhore për mosdorëzim të raporteve financiare në tërësi si subjekt zgjedhor.
 - Sanksion për kandidatët për kryetar bashkie të cilët kanë pranuar fonde private me vlerën më të madhe se pesëdhjetë mijë lekë, nëpërmjet formave të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare.
 - Sanksione për kandidatët për kryetar bashkie për pranimin e fondeve nga donatorë të ndaluar.
 - Sanksione për subjektet zgjedhore dhe OSHMA-të për mosbashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
 - Sanksione për ofruesit e shërbimeve të mediave audio-vizive për mosdorëzim të tarifave.
- Për sa më lart brenda kompetencave të parashikuara në Kodin Zgjedhor, përpara jush projektvendimi. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: mirë, faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Drejtësi Integrim e Unitet, në lidhje me projektvendimin!

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Faleminderit zoti Komisioner! Jemi dakord për sa i përket projektvendimit. Thjesht dua të bëj një sqarim në lidhje me pjesën ku PDIU, në 53 bashki që ka paraqitur listën e kandidatëve, sepse për këtë është pjesa që ajo është propozuar për të vendosur gjobë nga 5-10 milion lekë. Në listën e kandidatëve nga 1465 kandidatë, vetëm 44 kandidatë nuk kanë depozituar në PDIU, por dhe në KQZ, dokumentacionin financiar. Unë mendoj se siç ka ndodhur shpesh në këtë komision që për shumë kandidatë si në zgjedhjet vendore por dhe ato parlamentare, KQZ-ja ka marrë në shqyrtim, për sa i takon ligjit të dekriminalizimit, plus dhe gjërave të tjera që kanë pas këta kandidatë, mendojmë se kjo gjobë, zoti Komisioner

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

duhet t'i vendoset kandidatëve të cilët janë ata personat që nuk e kanë plotësuar këtë dokumentacion. Pra, nuk kanë bërë deklarinimin e shpenzimit financiar për sa i përket fushatës së tyre. Ne mendojmë të shihet nga ana juaj në vendimin që do të merrni për sa i përket kësaj gjobe për t'ju vendosur subjektit PDIU. Nuk varet nga ne depozitimi i këtyre drafteve financiare që ata kanë për detyrë sipas kodit, për t'i depozituar. Propozimi është që gjoba të vendoset për këta kandidatë, jo për subjektin partiak.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Shkelja që është konstatuar për Partinë Drejtësi, Integrim e Unitet ka të bëjë me mosparaqitjen e raporteve financiare nga disa prej kandidatëve?!

Znj. J. Josifi: Po!

Z. I. Celibashi: Në referim të nenit 173, pika 3 dhe ka të bëjë me fjalinë e dytë të këtij paragrafi “Mosparaqitja e raportit në shkelje të rregullave dhe formateve të standartizuara të miratuara nga KQZ”. Konkretisht kjo shkelje është për këtë parti! Nuk ka të bëjë me elementë të tjerë të formës, apo dhe të përmbajtjes të formateve, apo të përmbajtjes.., vetëm për faktin se 44 ...

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: 44 kandidatë të tillë nuk i kanë paraqitur këto raporte financiare.

Z. I. Celibashi: Dakord! Mirë faleminderit! Kemi gjë tjetër? Jo nuk kemi! Atëherë edhe njëherë për ta përmbledhur! Në lidhje me shkeljet e presupozuara të kryera nga partitë politike, ato kanë të bëjnë me mosrespektimin e afatit të dorëzimit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

të raportit, si dhe me paraqitjen e këtyre raporteve në shkelje të rregullave që kanë të bëjnë me formatet e standartizuara të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për sa i përket shkeljeve të presupozuara për kandidatët, ato kanë të bëjnë kryesisht me fonde të cilat ata i kanë marrë jo sipas formës së parashikuar nga ligji, pra jo nëpërmjet llogarive bankare, por i kanë marrë “kesh” në një vlerë mbi pesëdhjetë mijë lekë, gjë që është në kundërshtim me atë çfarë parashikon Kodi Zgjedhor, ose në ndonjë rast janë financuar nga donatorë të cilët ligji parashikon ndalime për këta donatorë për të bërë dhurime. Kjo është kategoria?!

Znj. J. Josifi: Po kjo është.

Z. I. Celibashi: Dakord! Kurse Partia Drejtësi, Integrim e Unitet dhe njëherë për ta rikonfirmuar, si shkelje i atribuohet fakti që për 44 kandidatë nuk ka mundur nga 1465. Ju i keni bërë përpjekjet për të komunikuar me ta?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU: Patjetër zoti Komisioner! Ne kemi bërë përpjekje, ju kemi kërkuar të paraqesin dokumentacionin, thjesht presim që të na i paraqesin, sepse ishte dhe afati kohor kur është dhënë nga ana e KQZ-së. Projektvendimi dhe një relacion na u dha para një muaji, kemi bërë sqarimet tona, jemi paraqitur pranë KQZ-së. Kemi sqaruar disa momente në lidhje me këtë raport financiar për sa i përket çështjeve që kishin të bënin me tarifat e televizioneve të ndryshme. Kemi plotësuar ato mangësi, por kjo ka qenë pjesa që ne nuk kishim mundësi, zoti Komisioner për t'i paraqitur, sepse duhet të na vinte dokumentacioni nga kandidatët. Ne nuk e dimë realisht se sa ka qenë shpenzimi që kanë bërë ata në zonat e tyre. Kjo ka të bëjë thjesht vetëm me Bashkinë Librazhd, për të qenë korrekt me ju. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*


Z. I. Celibashi: Nga procesi i konsultimit të këtij projektvendimi, kemi ndonjë koment, opinion nga parti politike, organizata të shoqërisë civile në lidhje me këtë projektvendim, ose çfarë kanë ardhur janë reflektuar?

Znj. J. Josifi: Po, kemi pasur mendime dhe komente. Kemi pasur kryesisht mendime të sjella kohë pas kohe përgjatë këtij një muaji që e kemi nxjerrë projektvendimin për konsultim publik, kryesisht nga organizata KRIIK. Kemi marrë parasysh ato komente të cilat pas verifikimit tonë vlenin për t'u përfshirë në projektvendim, siç ishte rasti i disa kandidatëve për kryetarë bashkie të cilët kishin përfituar fonde sërish, pra ndryshe jo me kalimin në llogari bankare, mbi pesëdhjetë mijë lekë, por e kishin bërë këtë gjë duke e copëzuar fondin në disa raste. Për administratën, nga ana jonë nuk u mendua se kjo do të duhej të përfshihej. Në fakt, logjika dhe argumentimi i KRIIK, për ne qëndronte. I riverifikuam këto dhurime. Ato e kalonin në total shumë prej pesëdhjetë mijë lekësh dhe janë përfshirë në këtë projektvendim. Gjithashtu KRIIK propozoi që e gjithë lista emërore e të gjithë kandidatëve për kryetarë bashkie, ashtu si dhe kandidatëve të listave shumëmemërore për secilin subjekt, të cilët nuk e kishin dorëzuar fare raportin financiar të bëhej publike dhe t'i atashohej projektvendimit. Edhe kjo është reflektuar. Çdo gjë tjetër e cila pas verifikimit tonë nuk rezultoi, nuk është reflektuar. Këto shpjegime janë dhënë në relacionin e projektvendimit që keni sot përpara.

Z. I. Celibashi: Dmth, ka qenë një donator i cili në kohë të ndryshme ka dhuruar “kesh” para ndaj një subjekti të caktuar, por është një?

Znj. J. Josifi: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

Z. I. Celibashi: Edhe në total, shuma e dhurimeve e kalon pesëdhjetë mijë lekëshin?

Znj. J. Josifi: Po, e kalon shumë pesëdhjetë mijë lekë.


Z. I. Celibashi: Edhe këto i keni përfshirë si gjetje të cilat vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor?

Znj. J. Josifi: Po!

Z. I. Celibashi: Dakord! Gjë tjetër nuk kemi?! Dakord! Mirë, në rregull, në vlerësimin tim, pretendimet e përfaqësuesit të Partisë Drejtësi, Integrim e Unitet qëndrojnë. Ato vijnë në përputhje me parashikimet e nenit 90, pika 4 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit kemi që subjekti zgjedhor mban përgjegjësi, sipas këtij ligji, për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve të lidhura me financimin nga ana e kandidatëve të saj, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se subjekti zgjedhor nuk ka pasur mundësi, ose me gjithë përpjekjet e bëra nuk ka arritur dot të parandalojë, ose të korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Mendoj se, ne jemi pikërisht pata këtij rasti, gjykuar kjo dhe nga aspekti sasior. Një raport i ndërmjet kandidatëve që i kanë paraqitur me numrin e kandidatëve të cilët nuk kanë depozituar deklaratimet e tyre përkatëse në lidhje me financimin. Pra, pretendimi i përfaqësuesit të Partisë Drejtësi, Integrim e Unitet, konsiderohet në vlerësimin tim i bazuar. Për këtë arsye do të përjashtohet nga propozimi për vendosjen e sanksionit administrativ për këtë shkak për këtë parti politike.

Mirë, atëherë përfundimisht vendosim:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

- Miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, sipas shtojcës që do t'i bashkëlidhet këtij vendimi.

Nga ana tjetër gjithashtu, bazuar në këto gjetje të këtij raporti,

- T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative si më poshtë:

- Për partinë politike Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian, gjobë në vlerën 500 000, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Për Partinë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Partia Aleanca Liberale e Djathtë, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, për shkelje të parashikuara nga neni 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Partia Aleanca Progresiste LZHK, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.


- Partia Ardhmërija Shqiptare, gjobë në vlerën e 500 000 lekëve, po për shkelje të parashikuara nga neni 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Partia Bindja Demokratike, gjobë në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

- Partia Fronti i Majtë, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

Zbardhi materialin audio


Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

- Partia Fryma e Re Demokratike, gjobë në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Lëvizja Puntore Shqiptare, gjobë në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare, gjobë në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen, në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Nisma Thurje”, në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Agrare Ambjentaliste, gjobë në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë, gjobë në vlerën e 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Balli Kombëtar, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Partia Demokracia Sociale, gjobë në vlerën 500 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Gjobë në vlerën e 500 000 lekëve për Partinë Demokratike, po sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Gjobë në vlerën e 500 000 lekëve për Partinë e Gjelbër, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Gjobë në vlerën e 500 000 lekëve për Partinë e Reformave Demokratike Shqiptare, po sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
- Për Partinë Emigracioni Shqiptar, gjobë në vlerën 500 000 lekëve, po sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*


- Gjobë në vlerën e 500 000 lekëve për Partinë Kombëtare Konservatore Albania.
- Për Partinë Komuniste të Shqipërisë, në këtë vlerë.
- Për Partinë Konservatore, po në këtë vlerë.

- Për Partinë Kristian Demokrate, po në vlerën e 500 000 lekëve.
- Për Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë.
- Për Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve.
- Për Partinë Republikane.
- Për Partinë e Unitetit Kombëtar.

Të gjitha këto sanksione në këtë vlerën e 500 000 lekëve të bazuara në nenin 173, pika 3 për partitë të cilat cituam më sipër. Ndërkohë,

- Për Partinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, gjobë në vlerën 2 000 000 lekëve, për mosdepozitim në afat të raportit financiar, pasi kjo është masa e sanksionit që parashikon Kodi Zgjedhor në këtë rast, për subjektet të cilat nuk dorëzojnë në afat raportin.
- Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, gjobë në vlerën 2 000 000 lekëve.
- Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.
- Partia Komuniste e Shqipërisë, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.
- Partia Uniteti Kombëtar, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.
- Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.
- Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.
- Partia Konservatore, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.
- Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.
- Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, gjobë në vlerën e 2 000 000 lekëve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

Të gjitha këto parti me këtë vlerë sanksioni nuk kanë depozituar raportin në afatin që ka përcaktuar ligji dhe kjo është taksative, si çështja e afatit, po ashtu dhe çështja e vlerës së gjobës.

Ndërkohë t'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative, për kandidatët për kryetarë bashkie si vijon, për shkak të mosrespektimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor që lidhen me mënyrën e marrjes së donacioneve. Kandidatët vijues i kanë marrë këto donacione jo në rrugë bankare dhe sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor do të duhet të sanksionohen me vlerën e donacionit të marrë si dhe e njejta vlerë do të duhet ta kthejë, ta dorëzojë në buxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Për kandidatin për kryetar të Partisë Socialiste, zotin Arif Tafani me gjobë në vlerën 206 000 lekëve.
- Për kandidatin për kryetar të Bashkisë Fier të Partisë Socialiste, zotin Armando Subashi në vlerën 138 910 lekë. Pavarësisht se një pjesë e tyre janë zgjedhur në detyrën e kryetarit, po sanksioni vendoset në cilësinë e tyre si kandidat.
- Për kandidaten për kryetare bashkie zonjën Emirjana Sako, të mbështetur nga Partia Socialiste për Bashkinë e Durrësit.
- Për zotin Kreshnik Hajdari kandidatin për kryetar të Bashkisë Kuçovë, mbështetur nga Partia Socialiste, në vlerën e 500 000 lekëve. Vlera e sanksionit administrativ dhe e detyrimit për të kthyer në buxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Për zonjën Emirjana Sako në vlerën 75 859 lekë.
- Për kandidaten e Bashkisë Roskovec, zonjën Majlinda Bufi, mbështetur nga Partia Socialiste në vlerën 243 500 lekë.
- Për kandidatin për kryetar, mbështetur nga Partia Socialiste, Bashkia Librazhd, zotin Mariglen Disha në vlerën 125 490 lekë.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

- Kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë e Burrelit zoti Agron Malaj në vlerën e 80 000 lekëve.
- Zoti Bukurosh Maci kandidat i Partisë Socialiste në vlerën e 70 000 lekëve.
- Kandidati Partisë së Lirisë, zoti Agron Loka në vlerën e 486 000 lekëve.
- Kandidati i Partisë së Lirisë, zoti Albert Mëlyshi gjobë në vlerën e 300 000 lekëve.
Bashkë me detyrimin për të gjithë këta, për të kthyer të njejtën vlerë në buxhetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kandidati i Partisë së Lirisë, zoti Ardit Cikuli në vlerën 259 958 lekëve.
- Po kandidati i Partisë së Lirisë, zoti Arjan Hoxha në vlerën 72 000 lekëve.
- Zoti Aurel Malko kandidat i Partisë së Lirisë, në vlerën 72 000 lekëve.
- Zoti Bardh Spahia në vlerën e 445 280 lekë.
- Kandidati i Partisë së Lirisë, zoti Bedri Hoxha në vlerën 156 715 lekë.
- Zoti Behar Haxhiu i mbështetur nga Partia e Lirisë, në vlerën 132 456 lekë.
- Zoti Besnik Dushaj në vlerën 178 758 lekë.
- Zoti Dëfrim Fiku kandidat i mbështetur nga Partia e Lirisë, në vlerën 192 294 lekë.
- Zoti Dorjan Lani i mbështetur nga Partia e Lirisë, po sanksion në vlerën 72 000 lekëve bashkë me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, në këtë vlerë.
- Zoti Edmond Komino në vlerën 198 000 lekë.
- Zoti Elvis Hajdërlli i mbështetur po nga Partia e Lirisë, në vlerën e 223 762 lekëve.
- Zoti Et'Hem Lumani, mbështetur po nga Partia e Lirisë, në vlerën e 169 000 lekëve.
- Zoti Evdar Kodheli në vlerën e 192 000 lekëve.
- Zoti Fatmir Shero në vlerën e 172 000 lekëve.
- Zoti Fisnik Qosja në vlerën e 392 220 lekëve.
- Zoti Hasim Çekrezi në vlerën e 107 440 lekëve.
- Zoti Hil Curri në vlerën e 72 000 lekëve.
- Zoti Hysni Sharra në vlerën e 452 311 lekëve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

- Zoti Igli Cara në vlerën e 368 135 lekë.
- Zoti Ismail Uka, gjobë në vlerën e 72 000 lekëve.
- Zoti Lefter Maliqi gjobë në vlerën e 170 000 lekëve.
- Për zotin Luçiano Boçi në vlerën e 72 000 lekëve.
- Për zotin Miftar Dauti në vlerën e 95 948 lekëve.
- Për zotin Pashk Gjoni në vlerën 171 000 lekëve.
- Për zotin Resmi Shanaj në vlerën 72 000 lekëve.
- Për zotin Shefki Cota në vlerën 118 000 lekëve.
- Për zotin Shkëlqim Hoxha në vlerën e 316 000 lekëve.
- Për zonjën Sofije Alushaj në vlerën e 80 100 lekëve.
- Për zotin Zija Ismaili në vlerën e 105 840 lekëve.
- Për zotin Zini Tollozhina në vlerën 188 000 lekëve.
- Për zotin Pjerin Ndreu në vlerën e 720 000 lekëve.

Ndërkohë i propozojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sanksion administrativ, në vlerën e 300 000 lekëve për Partinë Socialiste të Shqipërisë, për shkelje sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.

- Për Partinë Demokratike, në vlerën e 200 000 lekëve, po për shkelje sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.
- Për Partinë Agrare Ambientaliste të Shqipërisë”, në vlerën e 100 000 lekëve, për shkelje sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.
- Për Partinë Republikane, në vlerën 100 000 lekëve, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.
- Për Partinë Konservatore”, në vlerën 100 000 lekëve, për shkelje sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.
- Për Partinë Uniteti Kombëtar në vlerën e 562 618.08 lekë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

- Për Partinë Aleanca Demokristiane e Shqipërisë detyrimi për të kthyer në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shumën prej 448 974. 24 lekë, sipas nenit 88, pika 7 të Kodit Zgjedhor.

Ndërkohë i propozojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, vandosjen e masave administrative për Ofruesin e Shërbimit Mediatik audiovizive si më poshtë:


- Për Shijak TV 4 000 lekë.
- Për Bulqiza TV 4 000 lekë.
- Për Bulevard TV 4 000 lekë.
- Për RTV Shkodra 4 000 lekë.
- Për CAN TV 4 000 lekë.
- Për Ora News 5 000 lekë.
- Përsëri për Shijak TV, por sipas neneve 84, pika 5 përsëri 4 000 lekë.
- Për Syri TV, në masën e 5 000 lekëve.
- Për Fax News, për shkelje sipas nenit 173, pika 8 në masën e 100 000 lekë.
- Për MCN TV, për shkelje sipas nenit 173, pika 8 në masën e 100 000 lekëve.
- Për Syri TV, sipas nenit 173, pika 8 në masën 100 000 lekëve.
- Për Top News, për shkelje sipas nenit 173, pika 8 në masën e 100 000 lekëve.
- Për Koplík TV, për shkelje sipas nenit 173, pika 8 në masën e 100 000 lekëve.

Këto ishin masat e propozuara.

Mirë, e mbyllim këtë pikë të rendit të ditës.

Vendimi nr. 186

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :


KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi, z. K. Puleri,
z. M. Bardhi.
- Parti Politike:** PDIU (z. Sh. Sulo)
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të organizatës KRIIK në lidhje me shkeljet administrative të kryera nga personat përgjegjës gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.

Znj. M. Koja: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ka depozituar një denoncim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas të cilit në funksion të fushatës zgjedhore të kandidatit të Partisë Socialiste për kryetar të Bashkisë Himarë, zoti Tavo si dhe përfaqësues të kësaj partie, kanë zhvilluar në datën 01.08.2024, një takim elektorale, në Borsh, në oborrin e Shkollës së Mesme e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

Bashkuar “Qazim Pali”. Ky takim është postuar nga kandidati në faqen e tij zyrtare ku është bërë thirrje për të votuar në favor të tij. Pas administrimit të denoncimit, ka filluar procedura e hetimit administrativ. Janë njoftuar palëte denoncuara: zoti Tavo, Zyra Vendore e Arësimit Para Universitar Vlorë-Himarë dhe drejtori i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh si dhe subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Gjatë shpjegimeve të tij zoti Tavo sqaron se, pretendimet e bëra nga denoncuesi bazohen në fotot e marra nga profili në facebook i tij. Pohon se në datën 1.08.2024 është zhvilluar një takim zgjedhor në ambjentet e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh, ku ndër të tjera referohet se kanë qenë të pranishëm edhe zoti Klosi, përfaqësues i PS dhe drejtori i kësaj shkolle. Zoti Tavo pretendon se për sa i përket rastit konkret, në vlerësim të tij, në raport me parashikimet e Kodit Zgjedhor, në rastet e burimeve të sistemit shkollor para universitar nuk gjendemi para përdorimit të burimeve, pasi siç dokumentohet edhe nga fotot, aktiviteti nuk është zhvilluar brenda ambjenteve të shkollës, pra në klasa, apo zyra. Nuk është kaluar dera e shkollës së mesme, por veprimtaria është zhvilluar në ambjentin e jashtëm dhe argumenton pretendimin e tij duke u referuar specifikisht pikës 2 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor i harmonizuar me nenin 142 të Kodit Civil, ku sanksionohet qartë se burimi në rastin në fjalë është send i paluajtshëm, ndërtesa e lidhur me tokën, e trupëzuar me të në mënyrë të qëndrueshme. Sa i përket pjesëmarrjes së zotit Klosi dhe drejtorit të shkollës, zoti Tavo argumenton se për të dyja rastet, prevalon bindja politike, pjesmarrja në evenimente të tilla si një e drejtë e votës dhe e drejta për t’u aktivizuar. Në rastin konkret gjithshka është zhvilluar jashtë orarit të punës. Është kontaktuar Zyra Vendore e Arsimit Para Universitar Vlorë-Himarë. Sipas Zyrës Vendore të Arsimit Para Universitar Vlorë-Himarë, bën me dije se procesi mësimor për vitin shkollor 2023-2024, ka përfunduar në datën 14.06.2024. Pra, në datën 01.08.2024 nuk ka pasur as mësues e as nxënës në shkollë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

Kështu që nuk kemi pasur cënim të procesit mësimor, apo përdorim të detyruar të nxënësve, apo mësuesve në këtë aktivitet zgjedhor. Është kontaktuar dhe drejtori i shkollës së mesme të bashkuar, zonja Haide Dhuli e cila nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me rastin në fjalë. Ndërkohë, në përfundim të hetimit administrativ dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve të administruara,

- provohet se veprimtaria është veprimtari me karakter elektoral. Është kryer në ambjentet e jashtme të një institucioni publik, siç është Shkolla e Mesme e Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh, e paaksesueshme nga publiku i gjerë;

- vërtetohet se në këtë takime ka patur deklaramë, thënie për të votuar, pra është një veprimtari elektorale;

- provohet se në favor të kandidatit për kryetar në Bashkinë Himarë, me zhvillimin e fushatës në ambjentet e shkollës janë vendosur burime publike në mbështetje të tij;

- gjithashtu provohet se drejtori i shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, zonja Haide Dhuli, ka vënë në dispozicion të kandidatit për kryetar bashkie, ambjentet e shkollës për qëllime zgjedhore.


Palët janë njoftuar për seancën e sotme për të qenë prezent, por nuk i kemi prezent në seancë.

Z. I. Celibashi: Ndërkohë pretendimet i kanë paraqitur?

Znj. M. Koja: Po, i kemi administruar pretendimet e tyre.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! Faleminderit! Atëherë nga ajo çfarë u relatua dhe çfarë përmban i gjithë dokumentacioni në lidhje me këtë denoncim të bërë nga Organizata KRIIK, vlerësoj që qëndrojnë argumentet në lidhje me shkeljet e kryera nga drejtori

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 8.10.2024*

i shkollës si dhe kandidati për kryetar të bashkisë dhe propozoj për vendosjen e sanksionit administrativ:

- për drejtorin e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, sanksionin administrativ në vlerën e katër mijë lekëve;
- për kandidatin për kryetar të Bashkisë Himarë, propozoj vendosjen e sanksionit administrativ në masën e njëqind mijë lekëve.
- Për pjesëmarrjen e zotit Blendi Klosi në këtë aktivitet, në vlerësimin tim, nuk jemi në kushtet kur ligji atë e përcakton si subjekt ndaj të cilit mund të vendoset sanksion administrativ për pjesëmarrjen në një veprimtari elektorale. Kjo përgjegjësi është e atij që ka vendosur në dispozicion këtë aset publik dhe të kandidatit si subjekt zgjedhor. Zoti Klosi në këtë rast nuk është në cilësinë e subjektit zgjedhor.
Dakord, mirë! Çështje të tjera nuk kemi, faleminderit! Seanca mbyllet!

Vendimi nr. 187

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*